

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: *“Zhbllokimi i shkarkuesve dhe kanal ujëmbledhës”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **44130000-0**

PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventive dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga grupi qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit specialiste te fushës nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.*Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike,argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerivepër këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

VLERA E FONDIT LIMIT:

46.690.966 (*dyzet e gjashtë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë*) *lekë pa tvsh*

56.029.160 (*pesëdhjetë e gjashtë milion e njëzet e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë*) *lekë me tvsh*

Fondi Limit i perllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 ”Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre” i ndryshuar , në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK “Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve, bazuar ne dokumentat sipas buxhetit te bashkise te vitit 2023 të miratuara nga Këshilli Bashkiak si dhe dokumentave lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq**_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kritereve te pergjithshme te Pranim / Kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2020,2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit te kontratës qe prokurohet.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit per vitet 2020,2021,2022 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2022 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së kontratës që prokurohet ,dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marre së bashku gjatë pesë viteve të fundit të jete jo më të vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarët e bashkimit të cilët ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme në sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Formular vlerësimi
- Situacion përfundimtar të objektit,

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Fatura tatimore
- Vertetim për kryerjen me sukses të kontratës

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

- a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:
 1. NP 1 - A (Punime gërmimi në tokë)
 2. NP 7 - B (Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje)
 3. NP 9 - A (Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime)
 4. NS 18 - A (Punime topogjeodezike)

**Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë liçencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të liçencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë liçencë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" (shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi I kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikasi mit i kërkuar për kategori në respektiv e	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen në kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 1	<i>Punime gjurmimi në tokë</i>	1.Punime gjurmimi dhe me eskavator. 2.punime gjurmimi kanal	A	
NP 7	<i>Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vep ra kullimi e vaditje</i>	1.Punime në ushqyesin kakac. 2.Punime në sifonin Petrushe dhe sifonin Superstrada varezat kakac	B	
NP 9	<i>Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime</i>	1.Punimet për zhbllokimet dhe ujeleshuesit dhe riparimi i pusëve të komandimit	A	

NS 18	<i>Punime topogjeodezike</i>	1.Punime germim dheu me eskavator. 2.punime germim kanal	A	
-------	------------------------------	---	---	--

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate** (nga *Administratori i shoqërisë*), **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë të perfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet të jete :

Inxhinier Ndertimi (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë.10.09.1998 i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të këtë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj si dhe vendimin Nr.312, datë.5.5.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”

Inxhinieri ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve që vendosen në objekt, kryesisht për punimet: -Punimet e betonit-Punime e ndertimit të pusetave-Punime vepra të vogla arti

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi (1)
- Inxhinier Hidroteknik (1)
- Inxhinier Gjeodet (1)
- Teknik Ndertimi (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)

2. Diplomë

1(Nje) nga inxhinieret pjese e stafit te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikate trajnimi për *”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”*, e dhëne nga një organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

(Për pergjegjesin e sigurisë dhe mbrojtjen e shendetit duhet të paraqitet Certifikata perkatese dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit).

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht quhet i plotësuar edhe kur vetëm 1 operator ekonomik paraqit dokumentat për inxhinierin të pajisur me certifikate trajnimi për ”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”,

Argumentimi: Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.4 Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, ”Për Prokurimin Publik” datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6

-Sipas zerave të preventivit për punime në rrjetin hidraulik është kërkuar 1 inxhinier hidroteknik.
-1 inxhinier gjeodet bazuar në zerin e punimeve në preventiv për punime germimi .shtresash dhe punime

- 1Inxhinier ndertimi është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve që vendosen në objekt, kryesisht për punimet: -Punimet e betonit -Punime të ndertimit të pusëve -Punime vepra të vogla arti. Vetdeklarimin nga inxhinieri **ndërtimit** se ai është i disponueshëm për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës.

- 1 Teknik ndertimi .Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit do të asistojë punonjësit e tjerë në të gjitha punimet e ndertimit edhe duke i udhëzuar dhe ndjekur ecurinë e punimeve.

2.3.5 Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikata ISO të vlefshme:

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
3. ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)
4. PASS 99:2012 (Sistemi i integruar i menaxhimit).
5. EN-ISO 3834-2:2006 (për kërkesat e cilësisë për saldimitin e mjeteve metalike)
6. DS CEN/TR 15128:2005 (për standartet europiane për riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe kullimit)
7. BS EN 13331-1:2002 (për sistemin e veshjeve të kanaleve)

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 44 "Kërkesat e cilësisë", si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për "Hartimin e Kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat Iso .

Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes së objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë.Sistemi i menaxhimit të cilësië, shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 17(shtatembedhjete) punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Manovrator (3)**

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

Kur mjetet eskavator dhe autovinc, jane ne pronesi

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor

Kur mjetet eskavator dhe autovinc, jane me qera

Deklarate nga operatori ekonomik, qe ne rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune me manovratorin(i cili duhet te kete Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor) deri ne perfundimin e afateve te kontrates.

- **Shofer (2)**

Kur mjetet kamion vetshkarkues he kamioncine, jane ne pronesi

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Patente te Kategorise C leshuar nga organet kopetente

Kur mjetet kamion vetshkarkues dhe kamioncine, jane me qera

Deklarate nga operatori ekonomik, qe ne rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune me shoferin (i cili duhet te kete Patente te kategorise C leshuar nga organet kopetente) deri ne perfundimin e afateve te kontrates.

- **Murator (5)**

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit ,struktura te holla monolite betoni,riparim i strukturave te betonit, etj.

- **Karpentier (3)**

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit, tobinot e betonit, pusetat, ,riparimi i hyrje daljeve te strukturave per betonit, ndertim i urave te reja, vepra arti, etj.

- **Saldator (2)**

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit, konstruksione metalike te thjeshta per akses ne puseten e komandimit, etj.

- **Hekur kthyes (1)**

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit, pusetat, puseta komandimi,riparimi i hyrje daljeve te strukturave per betonit, ndertim i urave te reja, vepra arti, etj.

“Për punonjësit e mësipërm . “Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate per sigrimin teknik te punonjesve (e vlefshme);
ose
Deshmi kualifikimi e sigurimit teknik

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokuriminpublik” dhe nenit39, pika 6/c), tëVKM nr.285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorëtekonmikë tëdëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licenciminapo certifikimin e tyre).

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 46 persona**, per 9 muaj. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikëduhet të vetëdeklarojnëdisponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteret e percaktuara ne piken 2.3.7.Eshtë kerkuar që operatori ekonomik të ketë një staf prej 4 punonjësit për të realizuar punimet ,nga zberthimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar me Vendimin Nr.629, datë 15.07.2015 ”Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre ” .

PREVENTIV PUNIMESH

--	--	--	--	--	--	--

**OBJEKTI : ZHBLLOKIM I SHKARKUESVE DHE KANAL I UJËMBLEDHËSAVE,
BASHKIA MALIQ**

<i>N r.</i>	<i>Nr. Analize</i>	<i>EMËRTIMI I PUNIMEVE</i>	<i>Njësi a</i>	<i>Sasia</i>	<i>op,njesi</i>	<i>op,gjithesej</i>
1	3.2	Prerje bimë të vogla 0-10 cm	m2	6372	0.08	509.8
2	3.25/b	Gërmim kanalesh në tokë të butë, me krahe, me seksion deri 0.75 m2	m3	2829	3.6	10,184.4
3	3.47/1a	Mbushje, rafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, çdo 30 cm, toke të zakonshme	m3	2800	0.44	1,232.0
4	3.97/a	Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , në kanale gjerësi deri 2 m, prani uji ~ 2m kategoria III, me shk në toke	m3	4240	0.09	381.6
5	3.243/1	Struktura të holla monolite betoni prog, 0-11620 m, t= 8 cm. (Veshje e re betoni c16/20 për taban dhe skarpatat e kanalit)	m3	2756	13	35,276.8
6	3.243	Riparim i hyrjeve dhe daljeve të strukturave prej betoni të tonbinove ekzistuese e vepra arti të kanalit kryesor	m3	28	12.8	358.4
7	An	Ndërtimi i prizave të reja në kanal in kryesor Bxh (40*50)	copë	5	77	384.0
8	An	Ndërtim ura të reja auto HD=1.5m, B=3m, H=2m	copë	4	91	365.2
9	3.97/a	Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , në kanale gjerësi >2 m, toke zak, kategoria III, me shkarkim në tokë	m3	820	0.09	73.8
10	3.25/c	Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krahe, me seksion deri 0.75 m2	m3	186	5.24	974.6
11	An	Puseta e hyrjes dhe e daljes së sifonit	copë	1	138	137.6
12	An	Ankera Tipi 1	copë	10	57	573.0
13	An	Ankera Tipi 2	copë	12	56	675.6
14	4.740	F.V Tub çeliku φ=600, t= 6.3 mm	ton	45.373	3	128.4
15	2.195	H/izolim me dy duar bitum	m2	1028	0.42	431.8
16	2.196	H/izolim me dy duar bitum + 1 kk (mbështetëse + pus)	m2	42	0.7	29.4
17	3.97/a	Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , në kanale gjerësi >2 m, toke zak, kategoria III, me shkarkim në tokë	m3	888	0.09	79.9

18	3.25/c	Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	m ³	204	5.24	1,069.0
19	An	Puseta e hyrjes dhe e daljes së sifonit	copë	1	138	138.0
20	An	Ankera Tipi 1	copë	12	57	684.0
21	An	Ankera Tipi 2	copë	14	56	784.0
22	4.740	F.V Tub çeliku $\varphi=600$, $t= 6.3$ mm	ton	60.06	3	180.2
23	2.195	H/izolim me dy duar bitum	m ²	1302	0.42	546.8
24	2.196	H/izolim me dy duar bitum + 1 kk (mbështetëse + pus)	m ²	53	0.7	37.1
25	An	Zbrazja e rezervuarit me sistem sifon me tubacion HDPE DN300 PN10 $q=500$ l/s (Karikimi I tubacionit me elektropompë)	op	120	120	14,400.0
26	An	Punime për zhbllokimin e ujëlshuesit me injektim uji me presion të lartë PN25 dhe goditje mekanike	op	5	5	25.0
27	An-49	Prishje struktura betoni	m ³	4.5	35	158.4
28	An-4	Ndërtim pusete komandimi në bjefin e poshtëm të digës	copë	1	138	138.0
29	4.3	Konstruksione metalike të thjeshta për akses në pusetën e komandimit	ton	0.85	34	28.9
30	An-57	F.V Tub metalik $d=219$ mm për sistemin e komandimit të ujëlshuesit	ml	20	2	36.0
31	4.121/8	F.V. saraqineska çeliku me fllanxa , $d=200$ mm	copë	2	10	20.6
32	4.113/6	F.V. saraqineska çeliku çift, $d=200$ mm	copë	4	7	26.8
33	An	Zbrazja e rezervuarit me sistem sifon me tubacion HDPE DN300 PN10 $q=500$ l/s (Karikimi I tubacionit me elektropompë)	op	60	60	3,600.0
34	An	Punime për zhbllokimin e ujëlshuesit me injektim uji me presion të lartë PN25 dhe goditje mekanike	op	3.5	4	12.3
35	An-49	Prishje struktura betoni	m ³	2.5	35	87.5
36	An-4	Ndërtim pusete komandimi në bjefin e poshtëm të digës	copë	1		0.0
37	4.3	Konstruksione metalike të thjeshta për akses në pusetën e komandimit	ton	0.85	1	0.7
38	An-57	F.V Tub metalik $d=219$ mm për sistemin e komandimit të ujëlshuesit	ml	20	2	36.0
39	4.121/8	F.V. saraqineska çeliku me fllanxa , $d=200$ mm	copë	2	10	20.6
40	4.113/6	F.V. saraqineska çeliku çift, $d=200$ mm	copë	4	7	26.8

		SHUMA				73,853
--	--	--------------	--	--	--	---------------

- Nga zberthimi i preventivit oret e punes per cdo ze punimi rezultojne 73853.
- Oret në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore $73853 : 8 = 9231$.
kemi 9231 punëtorë për një ditë pune
- 9231 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 420 punëtorë për një muaj punë.
- 420 punetore shpërndarë sipas grafikut per 9 muaj, rezulton 46 punëtorë për 9 muaj.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si me poshte :

Mjetet	Sasia	Gjendja
1. Eskavator me zinxhir	2 copë	Pronësi ose me qera
2. Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera
3. Tokmak elektrik	1 copë	Pronësi ose me qera
4. Motobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
5. Motosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
6. Kamion vetshkarekues deri ne 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
7. Kamioncine deri 3.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
8. Vibrator betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
9. gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
10. matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme
5. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

dhe per mjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)

4. *Police sigurimi (e vlefshme)*
5. *Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]*
6. *Certifikate per leje transporti te leshuar nga Bashkia*

Ne rastin e mjeteve me qera sipas njoftimit te APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit ,mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.

b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre duke paraqitur aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

1- Eskavator me zinxhir 2 copë

Bazuar në zërat e preventivit të punimeve per germim dheu me eskavator , kërkohet që operatori ekonomik të disponojë 1 mjet germimi Eskavator.

2- Autivinç 1 copë

Pwr ngritjen e pajisjeve te renda eshte kerkuar qe operatori ekonomik te kete 1 autovinç.

3- Tokmak elektrik 1 copë

Për realizimin e zërave të punimeve ngjeshje shtresash eshte kërkuar 1 tokmak elektrik

4- Motobetoniere 2 copë

Bazuar në zërin e preventivit për punime betoni jane kerkuar 2 motobetoniere.

5- Motosalldatrice 1 copë

Bazuar në zërin e preventivit për fv tubo e rakorderi metalike eshtë kërkuar 1 motosalldatrice.

6- Kamion vetshkarkues 1 cope

Bazuar në zërin e preventivit transport dheu,shtresë betony ,zhavori , furnizime material te ndryshme kerkohet 1 kamion vetshkarkues .

7- Kamioncinë 1 cope

Është kërkuar 1 kamioncine për transportin e materialeve të ndryshme dhe të punonjësve

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*